

Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare

Albania Leasing Sh.a

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4
Shënimet për Pasqyrat Financiare	5-40

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Aksionarët dhe Bordin Drejtues të Albania Leasing Sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Albania Leasing Sh.a ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2022, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2022, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri



30 qershor 2022



Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Aktivet			
Aktivet afatshkurtra			
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	7	24,226,775	11,745,412
Qira financiare e arkëtueshme	8	238,978,903	247,255,515
Tatim fitim i arkëtueshem		894,411	438,898
TVSH e arkëtueshme	9	13,415,127	13,340,676
Kolaterale të riposeduara	10	6,124,051	11,031,556
Parapagime dhe aktive të tjera	11	16,382,911	35,344,136
Totali i aktiveve afatshkurtra		300,022,178	319,156,193
Aktivet afatgjata			
Qira financiare e arkëtueshme	8	412,581,466	465,046,633
TVSH e arkëtueshme	9	27,074,190	25,744,736
Aktivet afatgjata materiale	12	731,009	837,152
Aktivet afatgjata jo-materiale	13	1,150,469	3,727,784
Totali i aktiveve afatgjata		441,537,134	495,356,305
Totali i aktiveve		741,559,312	814,512,498
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	14	13,631,974	19,179,566
Linja financimi	15	124,727,396	190,356,326
Totali i detyrimeve		138,359,370	209,535,892
Detyrime afatgjata			
Linja Financimi	15	211,396,516	196,013,602
Totali i detyrimeve		211,396,516	196,013,602
Kapitali			
Kapitali aksionar	16	560,120,000	560,120,000
Humbje të mbartura		(151,156,996)	(151,188,535)
Fitimi i vitit		(17,159,578)	31,539
Totali i kapitalit		391,803,426	408,963,004
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit		741,559,312	814,512,498

Këto pasqyra financiare u miratuan nga drejtimi i shoqërisë Albania Leasing Sh.a. në 31 mars 2023 dhe u nënshkruan nga:


Z. Fatmir Sulo
 Drejtor i Përgjithshëm

 NIPT: L32026007U
 Tirana, Albania

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga qiraja financiare	57,548,338	60,123,941
Shpenzime financiare	<u>(20,628,185)</u>	<u>(20,280,886)</u>
Të Ardhura nga Qiraja Financiare Neto	36,920,153	39,843,055
Shpenzime operative		
Shpenzime personeli	18 (20,381,009)	(19,475,506)
Shpenzime amortizimi	12, 13 (2,859,765)	(5,249,466)
Shpenzime të tjera operative	19 (14,967,386)	(13,926,517)
Totali i shpenzimeve operative	(38,208,160)	(38,651,489)
Të ardhura të tjera		
Të ardhura të tjera nga shërbimet	21 7,792,227	9,291,099
Fitime nga kurset e këmbimit, neto	<u>(20,253,453)</u>	<u>(7,894,710)</u>
Të ardhura të tjera, neto	(12,461,226)	1,396,389
(Shpenzim)\ Rimarrje provizioni të qirasë financiare të arkëtueshme	8 (889,668)	57,619
Shpenzime e provizionit	20 (892,750)	(1,813,534)
Shpenzim provizioni për aktivet e riposduara	<u>(1,627,927)</u>	<u>(222,756)</u>
Fitimi/(Humbja) përpara tatimit	(17,159,578)	609,284
Shpenzime për tatim fitimin	21 -	(577,745)
Fitimi neto e vitit	(17,159,578)	31,539
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-
Totali i fitimit/(humbjes) gjithëpërfshirëse	(17,159,578)	31,539

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5-40 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksionar	Humbje/Fitim të mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2021	560,120,000	(151,188,535)	408,931,465
Fitimi i vitit	-	31,539	31,539
Gjendja më 31 dhjetor 2021	560,120,000	(151,156,998)	408,963,002
Fitimi i vitit	-	(17,159,578)	(17,159,578)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	560,120,000	(168,316,574)	391,803,426

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri më 40 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		(17,159,578)	609,285
Rregullime për:			
Amortizimi	10, 11	2,859,765	5,249,466
Provizionimi i qirave financiare të arkëtueshme	8	892,750	1,813,534
Të ardhura nga qiraja financiare		(57,548,338)	(60,123,941)
Shpenzime financiare		20,628,185	20,280,886
		(50,327,216)	(32,170,771)
Ndryshimet në kapitalin punues:			
(Rritje)/ ulje në qiranë financiare të arkëtueshme		59,014,256	(3,260,297)
Ulje/ (rritje) në aktivet e tjera		22,464,825	19,618,858
(Rritje)/ ulje në llogaritë e pagueshme		(6,003,105)	2,651,976
		25,475,976	(13,160,234)
Të ardhura nga qiraja financiare të arkëtuara		50,383,111	59,375,036
Shpenzime financiare të paguara		(20,628,185)	(25,364,707)
Rrjedhja e parasë së përdorur në aktivitetet operative		62,903,686	20,850,095
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(176,307)	(1,080,738)
Nxjerrje jashtë përdorimit		-	-
Rrjedhja e parasë së përdorur nga aktivitetet investuese		(176,307)	(1,080,738)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Ulje/ (rritje) në Linjat e Financimit		114,230,000	227,331,697
Pagesa të borxhit		(164,476,016)	(258,726,447)
Rrjedhja e parasë së gjeneruar nga aktivitetet financuese		(50,246,016)	(31,394,750)
Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre		12,481,363	(11,625,393)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj në fillim të periudhës		11,745,412	23,370,805
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj në fund të periudhës	6	24,226,775	11,745,412

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri më 40, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Albania Leasing sh.a. ("Shoqëria") u themelua me 2 gusht 2013 si një Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin Nr. 9901 datë 14 prill 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe u regjistrua me Numër Identifikimi Tatimor L32026007U.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është qiraja financiare në përputhje me Ligjin 9396 datë 12 maj 2005 "Për Qiranë Financiare", i ndryshuar, dhe ligjin Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë". Operacionet dhe aktivitetet e Shoqërisë janë të bazuara në parimet e Financimit Islamik. Në këtë mënyrë Shoqëria siguron financim klientëve që kryejnë biznes në një mënyrë etike dhe të përgjegjshme, kanë pozicion financiar të qëndrueshëm dhe me pritshmëri për tu rritur, ndryshe nga biznese të pijeve alkoolike, duhanit, prodhimit të armëve dhe tregtisë së tyre, lojërat e fatit dhe biznese të ngjashme.

Albania Leasing ka marrë licencën për kryerjen e aktivitetit të qirasë financiare në 21 prill 2014. Shoqëria operon në zyrat e marra me qira në adresën Rruga "Asim Zeneli", Nr.12, Kati 2, Tiranë, Shqipëri. Kapitali i paguar i Shoqërisë me 31 dhjetor 2016 përbëhet nga EUR 4,000,000 ose ekuivalent në LEK 560,120,000.00. Struktura e zotërimit të aksioneve të Shoqërisë është si më poshtë:

Aksionerët	Kuotat e zotëruara	Kuotat e zotëruara në %
Islamic Corporation for the Development of the Private Sector	1,425,400	35.63
National Commercial Bank	1,199,600	29.99
Kolon World Investment Co.	500,000	12.50
Nd Real Estate Doool Tetovo	875,000	21.88
Totali	4,000,000	100.00

Bordi i Drejtorëve të Albania Leasing Sh.a. është i përbërë si më poshtë:

- Z. Mehmet Seyhan Pencapligil, Kryetar i Bordit të Drejtorëve
- Z. Asif Mahmud, Nën Kryetar i Bordit të Drejtorëve
- Z. Tural Bakhshaliyev, Anëtar
- Z. Sang Ho Shin, Anëtar
- Z. Bejtım Xhelili, Anëtar
- Znj. Admira Llazari, Anëtar

Deri me 31 dhjetor 2022, Shoqëria ka 9 të punonjës të punësuar (31 dhjetor 2021: 8 të punësuar).

2 Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare (këtu e më poshtë referuar “pasqyrat financiare”) janë përgatitur në përputhje me kërkesat për raportim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (“BNSK”). Më poshtë paraqiten politikat kontabël kryesore të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në bazë të parimit të vijmësisë, i cili supozon që shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë e saj operacionale edhe në periudhat në vazhdim.

Detaje për politikat kontabël të Shoqërisë, janë përfshirë në Shënimin 4.

2.2 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare “Lekë”, e cila është monedha funksionale si rrjedhojë e mjedisit ekonomik ku ajo operon, dhe të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në Lek, përveç aty ku shprehet ndryshe.

3 Ndryshime në politikat kontabël

3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara

Disa standarde të kontabilitetit që kanë hyrë në fuqi nga 1 janari 2022 dhe që kanë qenë të miratuara, nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin e Shoqërisë. Për këtë arsye, informacioni shpjegues në lidhje me këto standarde nuk është dhënë në pasqyrat e Kompanisë.

3.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive

Standardet dhe ndryshimet që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Shoqëria përfshijnë:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Referencat në Kornizën Konceptuale
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata me kushte rënduese - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-korente (ndryshime në SNK 1)
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet nga një transaksion i vetëm

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye dhënia e informacioneve shpjeguese nuk është bërë.

4 Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria gjatë gjithë periudhës së prezantuar në këto pasqyra financiare.

4.1 Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike përveç aktiveve financiare të vlefshme për shitje, të cilat janë paraqitur me vlerë të drejtë.

4.2 Transaksionet në monedhë të huaj

a) Monedha prezantuese dhe funksionale

Monedha funksionale është monedha e mjedisit kryesor ekonomik ku Shoqëria vepron. Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lekë Shqiptar, që është monedha funksionale dhe e prezantimit të Shoqërisë.

b) Transaksionet dhe balancat në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin.

Në fund të çdo periudhë raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë regjistrohen në monedhë të huaj dhe rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Kurset e këmbimit të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare për monedhat kryesore si në më 31 dhjetor 2022 janë si vijon:

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
EUR	114.23	120.76
USD	107.05	106.54

4.3 Interesat nga të arkëtueshmet nga qiraja financiare

Norma efektive e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimit të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme deri në

- shumën e mbartur të aktivitetit financiar; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar

Për llogaritjen e normës efektive të interesit për instrumentet financiare përveç aktivitetit financiar me kredit të zhvlerësuar të blera apo të krijuara, Shoqëria vlerëson rrjedhën e parasë në të ardhmen duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo Humbjet e Pritshme të Kredisë (HPK-së). Për aktivitetit financiar me kredit të zhvlerësuar të blera apo të krijuara, norma efektive e interesit e rregulluar llogaritet duke përdorur rrjedhën e parasë të vlerësuar të zvogëluar për HPK-të.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.3 Interesat nga të arkëtueshmet nga qiraja financiare (vazhdim)

Norma efektive e interesit (vazhdim)

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet, dhe zbritjet ose primet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes së një aktivi ose detyrimi financiar.

Kosto e amortizuar dhe vlera kontabël bruto

Kosto e amortizuar e aktivitet ose detyrimit financiar përbën shumën me të cilën aktivi dhe detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus ripagesat e principalit, plus ose minus vlerën e amortizimit të akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për të gjitha ndryshimet midis shumës fillestare që është njohur dhe shumës së maturuar dhe, për aktivet financiare, duke zbritur ndonjë zhvlerësim për humbje të pritshme të kredisë.

Shuma bruto e mbartur e një aktivi financiar përbën koston e amortizuar të aktivitet financiar përpara rregullimit për ndonjë zhvlerësim për humbje të pritshme të kredisë.

Llogaritja e të ardhurave nga interesi dhe shpenzimeve të interesit

Norma efektive e interesit të një aktivi ose detyrimi financiar matet në fazën e njohjes fillestare të aktivitet dhe detyrimit financiar. Për llogaritjen e të ardhurave nga interesi dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit aplikohet për shumën e mbartur bruto të aktivi (nëse aktivi nuk zhvlerësohet) ose për koston e amortizuar të detyrimit.

Megjithatë, për aktivet financiare të cilat janë zhvlerësuar pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi maten duke aplikuar normën efektive të interesit për koston e amortizuar të aktivitet financiar. Nëse aktivi nuk vazhdon të zhvlerësohet më tej, atëherë matja e të ardhurave nga interesi do të bëhet në bazë të vlerës bruto.

Për aktivet financiare të cilat janë zhvlerësuar në fazën e njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi maten duke aplikuar normën efektive të interesit të rregulluar të kredisë ndaj koston së amortizuar të aktivitet. Matja e të ardhurave nga interesi nuk aplikohet sipas metodës për shumën bruto, edhe nëse rreziku i kredisë së aktivitet përmirësohet.

Për informacion se kur aktivet financiare janë me kredit të zhvlerësuar.

Prezantimi

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) përfshijnë interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare të matur me kosto të amortizuar, të llogaritur në bazë të normës efektive të interesit.

Norma efektive e interesit

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nëpërmjet metodës së interesit efektiv. Norma efektive e interesit përbënte normën e cila bënte aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitet ose detyrimit financiar (ose, sipas rastit, për një periudhë më të shkurtër) për shumën e mbartur të aktivitet ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit llogaritet në momentin e njohjes fillestare të aktivitet dhe detyrimit financiar dhe nuk rishikohej më pas. Për llogaritjen e normës efektive të interesit, Shoqëria vlerësohte rrjedhën e parasë në të ardhmen duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo humbjet nga kredia në të ardhmen.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.3 Interesat nga të arkëtueshmet nga qiraja financiare (vazhdim)

Norma efektive e interesit (vazhdim)

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshinte të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet e transaksioneve dhe zbritjet ose primet që janë pjesë përbërëse të normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes së një aktivi ose detyrimi financiar.

4.4 Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to. Shpenzime të tjera nga komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat njihen si shpenzime në momentin që shërbimet përfitohen.

4.5 Aktivet dhe detyrimet financiare

Njohja dhe matja fillestare

Shoqëria fillimisht njeh të arkëtueshmet nga qiraja financiare dhe detyrimet për institucionet financiare në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Aktivi ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për një instrument që nuk matet me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve, kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes ose emetimit të tij.

Klasifikimi

Në fazën e njohjes fillestare, Shoqëria klasifikon një aktiv financiar të matur me koston e amortizuar, vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj) dhe vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH).

Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk përcaktohet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH).

- aktivi mbahet në një model biznesi objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet për të arkëtuar flukset e mjeteve monetare kontraktuale;
- termat dhe kushte kontraktuale të aktivitetit financiar krijojnë në data të caktuara flukse monetare të llojit “vetëm pagesa principali dhe interesi” (VPPi).

Gjithashtu, në fazën e njohjes fillestare, Shoqëria në mënyrë të parevokueshme mund të vendos që një aktiv financiar, i cili i plotëson kushtet të matet me kosto të amortizuar ose me VDATGj, ta masë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse në këtë mënyrë eliminon ose zvogëlon ndjeshëm papajtueshmërinë kontabël që mund të rezultojë.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Vlerësimi i modeleve të biznesit

Shoqëria ka bërë një vlerësim të qëllimit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivel portofoli sepse pasqyron më mirë mënyrën e menaxhimit të biznesit dhe të paraqitjes së informacionit ndaj drejtimit. Informacioni që është marrë në konsideratë përfshin:

- politikat dhe objektivat e deklaruar për portofolin dhe zbatimin e këtyre politikave në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e menaxhimit fokusohet tek gjenerimi i të ardhurave nga interesat kontraktual, ruajtja e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhja e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimi i flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- mënyrën e vlerësimit të ecurisë së portofolit dhe raportimit tek drejtimi i Shoqërisë;
- rreziqet që çenojnë ecurinë e modelit të biznesit (dhe aktivet financiare që mbahen në këtë model biznesi) dhe strategjia për mënyrën e administrimit të këtyre rreziqeve;
- si kompensohen drejtuesit e biznesit (p.sh. nëse kompensimi bazohet me vlerën e drejtë të aktiveve që menaxhohen ose fluksin e mjeteve monetare kontraktuale që arkëtohen)

Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (VPPI)

Për qëllimet e këtij vlerësimi, 'principalit' përcaktohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' përkufizohet si shpërblim për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kreditit që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të huadhënies si dhe marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm VPPI, Shoqëria merr në konsideratë kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një kusht kontraktual që do të ndryshonte kohën dhe shumën e flukseve monetare kontraktuale të tillë që nuk do të përmbushte këtë kusht.

Në kryerjen e vlerësimit Shoqëria konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që do të ndryshonin shumën dhe kohën e pagesës së flukseve monetare; (karakteristikat e levës financiare);
- kushtet e parapagesës dhe zgjatjes së kontratës;
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset monetare nga aktive të caktuara (p.sh. hua jo-rekurs);
- karakteristika që modifikojnë elementin e vlerës në kohë të parasë – p.sh. rishikimi periodik i normave të interesit).

Riklasifikimet

Aktivitetet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, me përjashtim të periudhës pasi Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për drejtimin e aktiveve financiare. Shoqëria i klasifikonte aktivitetet financiare në Hua dhe të arkëtueshme.

Detyrimet financiare

Shoqëria klasifikonte detyrimet e veta financiare si detyrime të tjera financiare, të matura më pas me koston e amortizuar.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Çregjistrimi

Aktivitet financiare

Shoqëria nuk e njeh më një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara të cilat plotësojnë kriteret për çregjistrimin e tyre, që krijohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Për çregjistrimin e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit (ose vlerës së mbartur që i caktohet pjesës së aktivitetit të çregjistruar/fshirë) dhe shumës së (i) pagesës së arkëtuar (përfshirë çdo aktiv të ri të përfituar duke i zbritur detyrimin e ri të presupozuar) dhe (ii) fitimit ose shpenzimeve të akumuluar që njihen tek të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse njihet në pasqyrën e të ardhurave..

Shoqëria kryen transaksione nëpërmjet të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e aktiveve të transferuara, apo ndonjë pjesë të tyre. Në këto raste, aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në transaksionet në të cilat Shoqëria nuk mban dhe as transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi financiar dhe ruan kontrollin mbi aktivin, Shoqëria e çregjistron aktivin në momentin kur kontrolli mbi këtë aktiv është shuar.

Detyrimet financiare

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, anuluar apo kanë skaduar.

Modifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Aktivitet financiare

Nëse termat dhe kushtet e një aktivi financiar modifikohen, atëherë Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare të aktivitetit të modifikuar janë në thelb të ndryshme. Nëse flukset e mjeteve monetare janë thelbësisht ndryshe, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar fillestar konsiderohen të shuara. Në këtë rast, aktivi financiar fillestar nuk njihet dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerë të drejtë së bashku me të gjitha kostot e pranueshme të transaksionit. Të gjitha komisionet e arkëtuara si pjesë e modifikimit kontabilizohen si më poshtë vijon:

- komisionet të cilat merren në konsideratë për përcaktimin e vlerës së drejtë të një aktivi të ri dhe komisionet të cilat përfaqësojnë rimbursimin e kostove të pranueshme të transaksionit përfshihen në matjen fillestare të aktivitetit; dhe
- komisionet e tjera përfshihen në pasqyrën e fitim humbjeve si pjesë e fitimit ose humbjeve që rezultojnë nga çregjistrimi i aktivitetit.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Modifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Nëse flukset monetare modifikohen kur huamarrësi është në vështirësi financiare, atëherë qëllimi i modifikimit është zakonisht të maksimizojë rikuperimin e kushteve kontraktuale fillestare në vend të gjenerimit të një aktivi të ri me kushte thelbësisht të ndryshme.

Nëse Shoqëria planifikon të modifikojë një aktiv financiar sipas një mënyre e cila do të sjell faljen e flukseve monetare, atëherë së pari Shoqëria vlerëson nëse një pjesë e aktivitetit duhet të fshihet përpara se të kryhet modifikimi (shih në vijim politikën për fshirjen nga bilanci). Kjo qasje ndikon në rezultatin e vlerësimit sasior dhe nënkupton që kriteret për çregjistrimin e aktivitetit nuk përmbushen në këto raste.

Nëse modifikimi i një aktivi financiar, i cili matet me kosto të amortizuar, nuk sjell çregjistrimin e aktivitetit financiar, atëherë Shoqëria në fillim do të rillogaris vlerën e mbartur bruto të aktivitetit financiar duke përdorur normën efektive të interesit fillestar të aktivitetit dhe një rregullim që rezultojnë si të ardhura ose shpenzime nga modifikimi në pasqyrën e të ardhurave. Për aktive financiare me normë të ndryshueshme, norma efektive e interesit fillestar që përdoret për të llogaritur dhe matur të ardhura ose shpenzimet rregullohet për të reflektuar kushtet aktuale të tregut në kohën e modifikimit.

Të gjitha kostot ose komisionet që paguhen dhe komisionet që arkëtohen si pjesë e modifikimit rregullojnë vlerën e mbartur bruto të aktivitetit financiar të modifikuar dhe amortizohen përgjatë afatit të mbetur të aktivitetit financiar të modifikuar.

Nëse modifikimi kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten së bashku në humbje nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, paraqiten si të ardhura nga interesi të llogaritura nëpërmjet metodës së normës efektive të interesit.

Detyrimet financiare

Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar në fazën kur kushtet e tij modifikohen dhe flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë në mënyrë thelbësore. Në këtë rast, një detyrim financiar i ri në bazë të kushteve të modifikuara njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës së mbartur të detyrimit financiar që është çregjistruar dhe pagesës së kryer njihet në pasqyrën e fitim humbjeve. Pagesa e kryer përfshin aktive jo financiare të transferuara, nëse ka, dhe supozimin e detyrimeve, duke përfshirë detyrimin e ri financiar të modifikuar.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk kontabilizohet si çregjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit llogaritet duke aktualizuar flukset monetare të modifikuara me normën efektive të interesit fillestar dhe të ardhurat ose shpenzimet që rezultojnë njihen në pasqyrën e fitim humbjeve. Për detyrimet me norma të ndryshueshme, norma efektive e interesit fillestar që përdoret për të llogaritur dhe matur të ardhurat ose shpenzimet për modifikimin rregullohet për të reflektuar kushtet aktuale të tregut në kohën e modifikimit. Të gjitha kostot dhe komisionet që paguhen njihen si rregullim i shumës së mbartur të detyrimit dhe amortizohen gjatë afatit të mbetur të detyrimit financiar të modifikuar duke ri-llogaritur normën efektive të interesit të instrumentit.

Kompensimi

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten për shumën neto në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe synon t'i shlyejë ato në bazë neto ose të njohë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.5 Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme, si për shembull ato që lidhen me aktivitetin tregtar të Shoqërisë.

Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të përfitohet nga shitja e një aktivi ose që do të paguhet për të transferuar një detyrim, nëpërmjet një transaksioni të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në kapital, ose në mungesë të tij në tregun më të mirë në të cilin Shoqëria ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mospagimit të tij.

Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument.

Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me një periodicitet dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme të dhëna dhe informacion për çmimin.

Nëse në tregun aktiv nuk ka një çmim të kuotuar, atëherë Shoqëria përdor teknikat e vlerësimit të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave përkatëse të njohura dhe do të minimizojë përdorimin e të dhënave të paverifikueshme. Teknikat e vlerësimit që janë zgjedhur përfshijnë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të marrin në konsideratë për vlerësimin e çmimit të një transaksioni.

Treguesi më i mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e pagesës së kryer ose të arkëtuar. Nëse Shoqëria vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk përcaktohet nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të ngjashëm dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna nga tregje të verifikueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, dhe rregullohet për diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Në vijim, diferenca njihet në fitim humbje siç duhet gjatë kohëzgjatjes së instrumentit, por jo më vonë se periudha kur vlerësimi është plotësisht i mbështetur me të dhëna të njohura në treg ose kur mbyllet transaksioni.

Zhvlerësimi

Shoqëria njeh humbjet nga zhvlerësimi për HPK për të arkëtueshmet nga qiraja financiare me një vlerë të barabartë me HPK-të përgjatë gjithë jetës, me përjashtim të instrumenteve financiare, për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm nga momenti i njohjes së tyre fillestare, për të cilat HPK matet si humbje të pritshme të kredisë për 12 muaj.

HPK-të për 12 muaj përbëjnë pjesën e humbjeve të pritshme të kredisë që rezultojnë nga ngjarjet e mospagimit për një instrument financiar të cilat janë të mundshme brenda një periudhe 12 mujore pas datës së raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihen HPK-të për 12 muaj referohen si “instrumente financiare të nivelit 1”. HPK-të përgjatë gjithë jetës janë humbje të pritshme të kredisë që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagimit përgjatë kohëzgjatjes së pritshme të instrumentit financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihen HPK-të përgjatë gjithë jetës, por nuk janë me kredit të zhvlerësuar referohen si “instrumente financiare të nivelit 2”.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi (vazhdim)

Matja e HPK-ve

HPK-të përbëjnë një vlerësim të probabilitetit të ponderuar të humbjeve të kredisë. Ato maten si më poshtë vijon:

- aktivet financiare që nuk zhvlerësohen në datën e raportimit: si vlera aktuale e të gjitha mjeteve monetare (p.sh. diferenca midis flukseve të mjeteve monetare ndaj njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që Shoqëria pret të marrë);
- aktivet financiare që zhvlerësohen në datën e raportimit: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara;

Aktivitet financiare me kredit të zhvlerësuar

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivet financiare që maten me kosto të amortizuar zhvlerësuar. Një aktiv financiar është me kredit të zhvlerësuar nëse ka ndodhur një ose më shumë ngjarje të cilat kanë pasur një ndikim jo të favorshëm në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivitetit.

Treguesi që një aktiv financiar është zhvlerësuar përfshin të dhënat e mëposhtme të verifikueshme:

- vështirësitë financiare të konsiderueshme të huamarrësit ose emetuesit;
- shkelja e detyrimeve të kontratës si për shembull ngjarja e mospagesës ose pagesës së vonuar;
- ristrukturimin e një huaje ose paradhënien nga Shoqëria me kushte të cilat Shoqëria nuk do t'i konsideronte në një situatë tjetër);
- tregues që një huamarrës do të falimentojë ose të jetë subjekt i riorganizimit financiar; ose
- zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë për shkak të vështirësive financiare.

Një e arkëtueshme nga qiraja financiare që është rinegociuar për shkak të përkeqësimit të kushteve të huamarrësit në përgjithësi konsiderohet me kredit të zhvlerësuar, me përjashtim të rastit kur ekzistojnë treguese që rreziku i mos arkëtimit të flukseve monetare kontraktuale është ulur ndjeshëm dhe nëse nuk ka asnjë tregues tjetër të zhvlerësimit.

Paraqitja e provizionit për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar

Provizioni për HPK paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar si zbritje nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

Fshirja

Të arkëtueshmet nga qiraja financiare fshihen (pjesërisht ose tërësisht) nëse nuk ka asnjë pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e aktivitetit financiar në tërësinë e tij ose të një pjese të tij. Në përgjithësi është rasti kur Shoqëria vendos nëse qiramarrësi nuk ka aktive ose burime të të ardhurave të cilat mund të gjenerojnë flukse monetare të mjaftueshme për të ripaguar shumat që janë subjekt i fshirjes. Vlerësimi realizohet në nivelin e aktivitetit individual. Rikuperimi i shumave të fshira më parë përfshihen në “zhvlerësimin e humbjeve të instrumenteve financiare” në pasqyrën e fitim humbjeve dhe tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Aktivitet financiare që janë fshirë mund të vijojnë të jenë ende subjekt i aktiviteteve të ekzekutimit të garancisë në zbatim të procedurave të Shoqërisë për rikuperimin e shumave që duhet të paguhen.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi (vazhdim)

Treguesi objektiv i zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi, Shoqëria ka vlerësuar nëse ka pasur fakte objektive që aktivet financiare të cilat nuk janë matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim humbjeve kanë qenë të zhvlerësuara. Një aktiv financiar ose grup i aktiveve financiare janë zhvlerësuar nëse faktet objektive kanë treguar se ngjarja e humbjes ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit (aktiveve) dhe se ngjarja e humbjes ka ndikuar në flukset monetare të ardhshme të aktivitetit (aktiveve) të cilat mund të vlerësoheshin në mënyrë të besueshme.

Treguesi objektiv që aktivet financiare kanë qenë të zhvlerësuara përfshijnë:

- vështirësi financiare të konsiderueshme të huamarrësit ose emetuesit
- mos përmbushje e detyrimeve ose shkelje e detyrimeve nga huamarrësi;
- ristrukturimin e një huaje ose paradhënie nga Shoqëria me kushte të cilat Shoqëria nuk do t'i konsideronte në një situatë tjetër;
- tregues që një huamarrës ose emetues do të falimentojë;
- të dhëna të njohura në lidhje me një grup aktivesh, si ndryshimet jo të favorshme në statusin e pagesës së huamarrësve ose emetuesve në grup, ose kushtet ekonomike të cilat lidhen me mos përmbushjen e detyrimeve në grup.

Një e arkëtueshme nga qiraja financiare që është rinegociuar për shkak të përkeqësimit të kushteve të huamarrësit në përgjithësi është konsideruar e zhvlerësuar, me përjashtim të rastit nëse kanë ekzistuar tregues që rreziku i mos arkëtimit të flukseve monetare kontraktuale është ulur ndjeshëm dhe nëse nuk ka pasur asnjë tregues tjetër të zhvlerësimit.

Vlerësimi individual ose kolektiv

Matja e zhvlerësimit individual është bazuar në vlerësimin më të mirë nga ana e drejtimit të vlerës aktuale të flukseve të parasë që priten të arkëtohen. Për vlerësimin e flukseve të parasë, drejtimi ka bërë vlerësime në lidhje me situatën financiare të debitorit dhe vlerën neto të realizueshme nga çdo kolateral i vendosur si garanci. Çdo aktiv i zhvlerësuar është vlerësuar në bazë të meritave që mbartin, dhe strategjisë së rikuperimit dhe çmuarjet e flukseve monetare që janë vlerësuar të rikuperueshme, janë miratuar në mënyrë të pavarur nga funksioni i Rrezikut të Kredisë.

Zhvlerësimi kolektiv për grupet e të arkëtueshme nga qiraja financiare me karakteristika të ngjashme është realizuar nëpërmjet metodave statistikore si metodologjia e normës së migrimit ose, për portofole të vegjël me informacion të pamjaftueshëm, me anë të një formule të bazuar në tendencat historike të normës të humbjes. Metodologjia e normës së migrimit ka përdorur analizën statistikore të të dhënave dhe tendencave historike në lidhje me mos përmbushjen e detyrimeve për të çmuar dhe vlerësuar shumën e humbjeve.

Zhvlerësimi për humbjet e ndodhura por të paraportuara (IBNR) ka mbuluar humbjet e kredisë të portofoleve të qirasë financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë nëse ka pasur fakte objektive të cilat kanë evidentuar se kanë përfshirë zëra të zhvlerësuar, por zërat e zhvlerësuar individualisht nuk mund të identifikoheshin.

Për vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv të humbjes, drejtimi ka vlerësuar faktorë si cilësia e kredisë, madhësia e portofolit, përqendrimi dhe faktorët ekonomik. Për të vlerësuar zhvlerësimin e duhur, supozimet janë bërë për të përcaktuar mënyrën se si humbjet e qenësishme janë modeluar dhe për të përcaktuar parametrat që duhet të regjistrohen, në bazë të përvojës historike dhe kushteve ekonomike aktuale.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.5 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Zhvlërësimi (vazhdim)

Vlerësimi individual ose kolektiv (vazhdim)

Saktësia e lejjimit varej nga supozimet e modelit dhe parametrat e përdorur në përcaktimin shtesa kolektive. Qiraja financiare e arkëtueshme që ishte subjekt i një provizioni kolektiv të IBNR nuk ishte konsiderohet e zhvlërësuar.

Matja e zhvlërësimit

Humbjet nga zhvlërësimi i aktiveve të cilat janë matur me kosto të amortizuar llogariten në bazë të diferencës së shumës së mbartur të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të fluksit të përlogaritur të mjeteve monetare të aktualizuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve.

Rimarrja e zhvlërësimit

Për aktivet e matura me kosto të amortizuar: Nëse një ngjarje e ndodhur pas njohjes së zhvlërësimit zvogëlon humbjen nga zhvlërësimi, zvogëlimi i humbjes nga zhvlërësimi rimerret përmes pasqyrës së fitim humbjeve. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar shumën dhe kohën e flukseve monetare të ardhshme janë rishikuar rregullisht për të reduktuar diferencën mes humbjes së vlerësuar dhe asaj aktuale

Humbjet nga zhvlërësimi për qira financiare individualisht të rëndësishme janë bazuar në vlerësime të flukseve monetare të ardhshme, të skontuara, për qiratë financiare individuale, duke marrë në konsideratë pagimin dhe realizimin e ndonjë aktivi të mbajtur si kolateral për qiratë financiare.

Paraqitja

Humbjet nga zhvlërësimi njiheshin në fitim humbje dhe pasqyroheshin në një llogari për fondin e zhvlërësimit të huave dhe të arkëtueshme. Interesat e aktiveve të zhvlërësuar kanë vijuar të njihen nëpërmjet konvertimit të zbritjes.

4.6 Të arkëtueshmet nga qiraja financiare

Të drejtat e arkëtueshme nga qiraja financiare në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë të drejtat e arkëtueshme nga qiraja financiare të matura me koston e amortizuar. Ato maten në fillim me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.7 Hua nga institucione të tjera financiare

Huatë e përfituara nga institucionet financiare janë burimet kryesore të financimit të Shoqërisë. Shoqëria i klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumente aksionare në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Huatë e përfituara nga institucionet financiare njihen fillimisht me vlerën e tregut plus kostot shtesë që lidhen direkt me transaksionin dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.8 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet e blera nga Shoqëria njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi aktivet afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë jetës së vlerësuar të aktivitetit jo-material nga data kur ato janë në dispozicion për përdorim.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.9 Aktive afatgjata materiale

a) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi. Blerja e programeve që janë të lidhur ngushtë me funksionalitetet e pajisjes përkatëse janë kapitalizuar si një pjesë e kësaj pajisje. Kur pjesët e një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçantë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

b) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbljedhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

c) Amortizimi/Zhvlerësimi

Vitet e vlerësuar të jetëgjatësisë deri në fund të 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

Aktive të qëndrueshme	Jetëgjatësia (vite) 2021	Jetëgjatësia (vite) 2022
Mobilje dhe Pajisje Zyresh	4-5 Vite	4-5 Vite
Kompjutera	4 Vite	4 Vite
Përmirësime të ambienteve me qira	5 Vite (afati i qirasë)	5 Vite (afati i qirasë)

Programet kompjuterike dhe aktivitetet e tjera jo-materiale të blera nga shoqëria janë të shprehura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar të zhvlerësimit. Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë jetës së vlerësuar të aktivitetit jo-material nga data kur ato janë në dispozicion për përdorim.

4.10 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur në mënyrë direkte në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave përmbljedhëse. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat e tatimit në datën e raportimit. Tatimi mbi fitimin llogaritet duke axhustuar fitimin statutor përpara taksave për disa zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve siç kërkohet nga Ligji Shqiptar.

Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 15% e fitimit të tatueshëm.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.10 Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatimi i shtyrë

Tatim fitimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke u bazuar në ligjet që kanë qenë ose janë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në qoftë se përfitimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit

Tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë i vitit njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, përveçse kur lidhen me zëra që njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në kapital, rast në të cilin tatim fitimi dhe tatimi i shtyrë njihen gjithashtu në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në pasqyrën e kapitalit përkatësisht.

4.11 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet 3 ose më pak muaj, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, investime të cilat shoqëria i përdor për menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e tyre të amortizuar.

4.12 Kapitali aksionar dhe dividendët

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitet me vlerën në Lekë të konvertuar me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale. Kapitali aksionar i cili është i nënshkruar për emetim, por që ende nuk është i regjistruar është i paraqitur veçmas në pasqyrën e lëvizjes së kapitalit. Një kontribut i pafinancuar i kapitalit, i cili është i pagueshëm në të ardhmen në një shumë të parapërcaktuar, është klasifikuar si kapital i paregjistruar dhe i paguar, përveç rasteve kur marrja e kontributit është vlerësuar në mënyrë të arsyeshme.

Dividendët

Shpërndarja e dividendëve për aksionarin e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare të Shoqërisë si detyrim në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionari i Shoqërisë.

4.13 Investime

Investimet përfshijnë një depozitë bankare afat-shkurtër të mbajtur me kosto.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.14 Përfitimet e punonjësve

Fondet e sigurimeve shoqërore dhe të shëndetit

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës

Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës njihen si shpenzim kur Shoqëria është e angazhuar dukshëm, pa mundësi reale tërheqjeje dhe kur Shoqëria njih kosto ristrukturimi. Nëse përfitimet nuk pritet të zgjidhen tërësisht brenda 12 muajve nga data e raportimit, atëherë ato skontojnë.

Plani i Kontributeve të Përcaktuara

Nën planin e kontributeve të përcaktuara, shuma e përfitimeve të ardhshme është përcaktuar nga kontributet e paguara dhe nga interesat e fituara të fondit. Detyrimet janë njohur në fitim apo humbje në periudhën e duhur dhe janë paraqitur interesa të shtuara të fondit të pensionit nga të ardhurat nga investimet.

Përfitimet afatshkurtra

Përfitimet afatshkurtra të punonjësve maten me bazë të paskontueshme dhe shpenzohen kur ofrohet shërbimi. Për vlerën e pritshme për tu paguar si përfitim monetar afatshkurtër ose sipas një plani fitim-shpërndarës krijohet një provizion nëse Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor dhe konstruktiv për të paguar këtë shumë si pasojë e një shërbimi të mëparshëm të dhënë nga punonjësi edhe ky detyrim mund të vlerësohet në mënyre të besueshme.

4.15 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të përdoren për shlyerjen e detyrimit.

Shuma e njohur si provigjon është vlerësimi më i mirë i shumës që kërkohet për të shlyer detyrimin aktual në fund të periudhës raportuese. Kur efekti i vlerës në kohë të parave është material, shuma e provigjonit është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kërkohen për të shlyer detyrimin.

Kur disa ose të gjitha përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer një provizion priten të mbulojnë nga një palë e tretë, një arkëtim njihet si një aktiv, nëse është praktikisht e sigurtë se rimbursimi do të merret dhe shuma e arkëtueshme mund të matet me besueshmëri.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.16 Qiraja financiare

Qiraja financiare klasifikohet si e tillë atëherë kur Shoqëria, si huadhënës në një marrëveshje qiraje financiare, transferon pothuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e aktivit, objekt i qirasë financiare. Qiraja financiare njihet në shumën e investimit neto dhe klasifikohet në kategorinë hua dhe llogari të arkëtueshme.

Qiraja financiare njihet fillimisht me vlerën e tyre të drejtë, neto nga kostot e transaksionit dhe matet më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura në bazën e interesit efektiv.

4.17 Të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas maten me vlerën e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.18 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënime shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënime shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provizionin, një detyrim njihet në datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

4.19 Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Të arkëtueshmet janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv letrash me vlerë, përveç atyre që shoqëria kërkon t'i shesë në periudhë afatshkurtër ose janë përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Të arkëtueshmet njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe pastaj maten me koston e amortizuar duke përdorur koston efektive të interesit, duke zbritur provizionin për zhvlerësim. Një provizion për amortizimin për llogaritë e arkëtueshme krijohet kur ka evidencë objektive që Shoqëria nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumat në përputhje me kushtet e tyre në momentin fillestar.

4.20 Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë për zhvlerësim. Nëse ka evidencë të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivit. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Vlera e rikuperueshme e një aktivi, ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të pasasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është zbutur, ose nuk ekziston më.

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë rimerret vetëm deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit e cila nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk do të kishte qene humbje nga zhvlerësimi i njohur.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.21 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen në fitim ose humbje gjatë përdorimit të shërbimit ose në datën në të cilën ato kanë ndodhur. Shpenzimet për garancitë njihen dhe ngarkohen kundrejt provizionit përkatës në momentin që njihet e ardhura e lidhur me to.

4.22 Të ardhura dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat e fondeve të investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave të huamarrjeve dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen bruto. Të ardhurat nga interesat njihen në bazë të të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.23 Transaksionet me palët e lidhura

Një palë konsiderohet e lidhur nëse:

- (a) direkt, ose indirekt, nëpërmjet një ose disa ndërmjetësve, pala:
 - (i) kontrollon, kontrollon nga, ose është nën kontrollin e përbashkët me njësinë ekonomike,
 - (ii) ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influence të konsiderueshme mbi njësinë; ose ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike;
- (b) pala është një pjesëmarrje;
- (c) pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës;
- (d) pala është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj;
- (e) pala është një familjar i afërt i ndonjë prej individëve referuar pikës (a) ose (d);
- (f) pala është një njësi ekonomike që kontrollon, bashkë kontrollon apo me ndikim të rëndësishëm, ose për të cilën ruan fuqinë më të madhe të votimit, direkt apo indirekt për çdo individ të referuar në (d) ose (e); ose
- (g) pala është një skemë e përfitimit pas – punësimit për përfitimin e punonjësve të njësisë ekonomike.

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve, pavarësisht nëse është vënë një çmim.

4.24 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e Shoqërisë në datën e Pasqyrës së Pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënime shpjeguese kur janë materiale.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.25 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara nga shoqëria.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilët besohet se janë të përshtatshëm dhe relevante për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhshme.

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një numër politikash kontabël dhe shënimesh shpjeguese të Shoqërisë kërkojnë matje sipas vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë që nuk shiten në një treg aktiv përcaktohen nga teknikat e vlerësimit. Shoqëria përdor gjykimin për të zgjedhur një numër të ndryshëm metodash dhe bën supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet e tregut në çdo datë raportimi. Shoqëria përdor analizën e flukseve të parasë të skontuar për gjetjen e vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare që nuk shiten në tregjet aktive. Kur një aktiv ose detyrim matet me vlerën e drejtë, Shoqëria përdor të dhëna tregu të vëzhgueshme për sa është e mundur.

Vlerat e drejta janë të kategorizuara në nivele të ndryshme hierarkie në bazë të dhënave të përdorura në teknikat e vlerësimit si më poshtë:

- **Niveli 1:** Çmimi i kuotuar (i pa rregulluar) në tregjet aktive për aktive ose detyrime të njëjta apo identike.
- **Niveli 2:** Të dhëna të tjera përveç çmimit të kuotuar të përfshirë në Nivelin 1 të cilat janë të vëzhgueshme, drejtpërdrejt (p.sh. çmimi) ose indirekt (p.sh. ato që derivojnë nga çmimi) për aktivin ose detyrimin.
- **Niveli 3:** Të dhëna për aktivin ose detyrimin të cilat nuk janë të bazuara në të dhëna tregu të vëzhgueshme (të dhëna jo të vëzhgueshme).

Nëse të dhënat e përdorura për të matur vlerën e drejtë të një aktivi ose detyrimi janë në nivele të ndryshme hierarkie, atëherë matja e vlerës së drejtë kategorizohet në tërësinë e saj në nivelin më të ulët hierarkik ku përfshihen të dhënat kryesore që përdoren për matjen e vlerës së drejtë.

Shoqëria i njeh transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

Vlerësimet e vlerave të drejta janë bazuar në paraqitjen e pozicionit financiar të instrumenteve ekzistuese financiare pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e aktiveve dhe pasiveve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë.

Mjete monetare dhe ekuivalentë me to përbëhen nga mjetet monetare në bankë. Duke marrë parasysh që këto teprica janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë konsiderohet e njëjtë me vlerën e tyre kontabël.

4 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

4.25 Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Tepricat e tyre kanë maturitet të shkurtër dhe vlerat e tyre kontabël përafrojnë me vlerën e tyre të drejtë.

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Tepricat e tyre kanë maturitet të shkurtër dhe vlerat e tyre kontabël përafrojnë me vlerën e tyre të drejtë.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhme për të njohur humbjet e pritshme të kredisë – “modeli i humbjeve të pritshme të kredisë (ECL)”. Kjo zëvendëson “modelin e humbjeve të ndodhura” sipas SNK 39. Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinë kreditë dhe aktivet e tjera financiare të huasë të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kredisë nuk varet më prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi bazë individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kredisë, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në pritshmërinë për të arkëtuar flukset e ardhshme monetare të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumenteve financiarë që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë (“Faza 1”) dhe
- instrumenteve financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilëve nuk është i ulët (‘Faza 2’).

‘Faza 3’ do të mbulojë aktivet financiare që kanë tregues objektivë të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kredisë “12 – mujore” njihen për kategorinë e parë, ndërsa “humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit” njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me parimin e vijueshmërisë, i cili nënkupton se Shoqëria do të vazhdojë operacionet e saj në një periudhë kohë të papërcaktuar, në të ardhmen e parashikuar.

Drejtimi pranon se pasiguria qëndron në ndryshimin e normës së kthimit si dhe në luhatjet e normës së interesit Euribor. Megjithatë, pret që Shoqëria të ketë burime të mjaftueshme që të sigurojë mbështetjen e duhur financiare për të vazhduar operacionin në të ardhmen, dhe të përmbushi detyrimet ndaj furnitorëve sipas planeve respektive të pagesës. Shoqëria nuk synon të likuidojë ose të ndërpresë biznesin e tij në të ardhmen.

Drejtimi pret që ajo të jetë fitimprurëse në të ardhmen dhe aftësia e saj për të vazhduar operimin të mos dëmtohet. Sipas buxhetit të Shoqërisë për vitin 2023, operacionet pritet të jenë fitimprurëse vitin e ardhshëm e në vazhdim. Gjithashtu, Shoqëria deri më 15.05.2023, ka realizuar një sasi totale të reja kontrata qiraje prej 1,470 mln euro

5 Menaxhimi i rrezikut financiar

5.1 Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare.

- rreziku i kredisë;
- rreziku i likuiditetit; dhe
- rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e rrezikut dhe menaxhimin e kapitalit.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimeve dhe standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

5.2 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë tjetër nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë

Maksimumi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 është paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Mjete monetare dhe ekuivalentë	24,226,775	11,745,412
Llogari të arkëtueshme	651,369	712,302,148
Aktive të tjera financiare	8,103,225	1,199,810
Totali	683,890,369	724,247,370

Shoqëria ka politika për të siguruar që qiratë financiare dhënë për klientët me një histori të kënaqshme të kreditit dhe një situatë financiare të shëndoshë. Rreziku i kredisë në lidhje me qiratë e arkëtueshme është i kufizuar për shkak të faktit se ata janë të siguruar nga aktivet e dhëna me qira.

5 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.2 Rreziku i kredisë (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të kredisë arrihet nëpërmjet:

- Formulimit të politikave të rrezikut të kredisë që mbulojnë vlerësimin e kredisë, vlerësimin e rrezikut dhe raportimin, procedurat dokumentare dhe ligjore, dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullatore dhe statutoare.
- Krijimit dhe monitorimit të niveleve delegeuse dhe rishikimit të procedurave lidhur me miratimin e qirasë financiare. Rishikimit dhe vlerësimin të rrezikut të kredisë. Drejtimi i Shoqërisë, përmes strukturave specifike të Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë, vlerëson të gjitha ekspozimet e limitit të kredisë para aprovimit përfundimtar dhe disbursimit.
- Rishikimit dhe vlerësimin të rrezikut të kredisë.
